

VENDIM
Nr. 198, datë 6.3.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “SCHOLZ” SHPK PËR IMPORTIN E MBETJEVE METALIKE, PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të pikës 3 të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “Scholz” sh.p.k. për importin e mbetjeve metalike, për qëllime riciklimi, me kodet tarifore, si më poshtë vijon:

- GA 720410 mbetje dhe kthime të gizës së derdhur;
- GA 720421 mbetje çeliku të pandryshkur;
- GA 720430 mbetje dhe kthime të gizës;
- GA 720441 copa të vogla, ashkla, feta, pluhur sharrimi, mbetje nga zbukurimet dhe stampimet, nëse janë në tufë;

- GA 740400 mbetje dhe kthime të bakrit;
- GA 750300 mbetje dhe kthime të nikelit;
- GA 760200 mbetje dhe kthime të aluminit;
- GA 780200 mbetje dhe kthime të plumbit;
- GA 790200 mbetje dhe kthime të zinkut;
- GA 800200 mbetje dhe kthime të kallajit.

Dhe kodin B1-B1010 të Konventës së Bazelit, aneksi 1 “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi””.

2. Sasia e mbetjeve metalike që do të importohet sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 30 000 (tridhjetë mijë) tonë në vit.

Mbetjet do të importohen nga vendet e Bashkimit Europian, Maqedonia, Kosova, Mali i Zi, Bosnjë-Hercegovina dhe Serbia. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, duke plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave e të procedurave për importimin e mbetjeve për përdorim, përpunim dhe riciklim”. Ambalazhimi i tyre do të bëhet në paleta i presuar në përputhje me përcaktimet e aneksit III bashkëlidhur vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në vendimin nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen, për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi””.

3. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, shoqëria “Scholz” sh.p.k. dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në aneksin IV bashkëlidhur vendimit nr. 550, datë 22.8.2012 të Këshillit të Ministrave dhe monitorimi i tyre do të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

4. Periudha e lejimit të importit të mbetjeve metalike nga shoqëria “Scholz” sh.p.k., do të jetë një 1-vjeçare, që do të fillojë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

5. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore merr masat e nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve metalike të sipërcituara nga shoqëria “Scholz” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi, për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato transitore, për autorizimet përkatëse që lejojnë kalimin e kësaj sasive të mbetjeve metalike,

në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, Konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha